

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant: **Specialist Jurist** pranë Departamentit Ligjor.

SPECIALIST JURIST

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitja dhe ofrimi i opinioneve ligjore.
- Përgatitja e marrëveshjeve, kontratave dhe memorandumeve të bashkëpunimit midis palëve.
- Shqyrtimi i projekt kontratave të propozuara dhe të parapërgatitura nga strukturat e tjera.
- Ofrimi i ndihmës lidhur me përmirësimet e nevojshme ligjore në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.
- Ndihma dhe orientimi i strukturave të shoqërisë në drejtim të njohjes, interpretimit dhe zbatimit të ligjit, akteve nënligjore, si dhe urdhrave të brendshëm.
- Dhënia e ndihmës në përgatitjen e kthim përgjigjeve të kërkesave për informacion, dokumentacion, në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.
- Ndjekja dhe trajtimi i problematikave me institucionet rregullatore, inspektuese, apo ato të orientuara në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
- Nën orientimin dhe rekomandimet e eprorit, kujdeset për hartimin e urdhrave, udhëzimeve dhe rregulloreve, që synojnë të rregullojnë marrëdhëniet e brendshme.
- Angazhimi në grupe pune të posaçme për çështje specifike sipas nevojës.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të zotërojnë Diplomë të arsimit të lartë të Fakultetit të Drejtësisë.
- Të ketë mbi 2 vite eksperiencë në pozicione pune të ngjashme.
- Të ketë aftësi shumë të mira të etikës dhe komunikimit.
- Të ketë marrë pjesë në trajnime apo programe master.
- Të njohë gjuhë të huaja, preferohet gjuha angleze.
- Të ketë njohuri të mira për programet bazë të kompjuterit.
- Të kryej detyrat e ngarkuara me përgjegjësi.
- Të ketë aftësi për të punuar në grup.

Dokumentat për dorëzim:

- Curriculum Vitae (CV).
- Letër Interesi – në të cilën duhet të specifikohen arsyet të cilat ju mendojnë se ju bëjnë një kandidat potencial për këtë pozicion.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.